



## In medias res

### Raport për monitorimet dhe vlerësimet e bëra në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë (2)

konstatime dhe vlerësime për zbatimin e projektit “Parandalimi i dhunës në shkolla”

Projekti ka filluar (Faza 1) të zbatohet nga shtatori i vitit 2008. Ka pushuar nga 1 janar 2010 deri më 15 dhjetor 2010, ndërsa, sërish, ka filluar të zbatohet më 15 janar 2010 (Faza 2&3) dhe do të vazhdojë deri me 31 dhjetor 2012.

Projekti financohet nga UNICEF, përkrahet nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (në vazhdim: MASHT) dhe nga Drejtoritë Komunale të Arsimit (në vazhdim nga DKA).

Faza e parë ka qenë pilotime-eksperimentale. Gjatë pilotimit janë arritur rezultate të dukshme pozitive. Këto rezultate kanë bërë që të vazhdojnë: Fazat 2&3 të projektit

- **Specifikë e veçantë e këtij projekti** është transparenca e bazuar në një monitorim dhe vlerësim të thellë, intensiv dhe objektiv (i bërë me instrumente valide, të besueshme dhe ndjeshme - që regjistrojnë dallimet më të vogla të gjendjes nga shkolla në shkollë).
- **Specifika e dytë e projekti është se:** monitorimet dhe vlerësimi janë bërë dhe bëhen mbi bazën e një Metodologjie të miratuar dhe të shqyrtuar të Monitorimit dhe të Vlerësimit
- **Specifika e tretë e projekti është:** arritjet e projektit verifikohen dhe argumentohen në mënyrë shkencore, meqë bazohen në një metodologji të avancuar të kërkimit dhe të hulumtimit

Në Fazën e parë, gjatë vitit 2009 janë monitoruar 169 shkolla në pesë komuna të Kosovës (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë dhe Pejë) Monitorimi ka për qëllim që të përhapë filozofinë dhe idetë kryesore të projektit, si dhe të pilotohet një struktura “virtuale” që e kemi përkufizuar si: Rrjeti Mbrojtës të Mjediseve të Sigurta. Me këtë rast janë bërë mbi 5 300 fotografi.

Në këtë vit nga muaji mars deri në muajin qershor janë vizituar 172 shkolla nga monitorues dhe vlerësues të ndryshëm: inspektorë të arsimit, drejtorë të Drejtorive Komunale të Arsimit, zyrtarë të DKA, përfaqësues të prindërve, anëtarë të OJQ-ve, kryetarë të Komiteteve Komunale e për të Drejtat e Fëmijës, kryetarë të Komiteteve Rajonale për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Gjatë monitorimit kemi gëzuar përkrahjen kryetarëve të Kuvendeve Komunale në Prizren, Rahovec, Kaçanik, Gjilan etj.

Monitorimet dhe vlerësimet gjatë këtij viti janë bërë në këtë komuna: Deçan, Gjakovë, Istog, Junik, Kaçanik, Mitrovicë, Pejë, Rahovec, Suharekë dhe Vushtrri.

Në Gjakovë, Pejë dhe Mitrovicë është bërë monitorimi dhe vlerësimi intermedial (monitorimi ndërmjet atij inicial që është bërë në vitin 2009 dhe të atij final që do të bëhet në gjysmë-vjetorin e dytë të këtij viti shkollor).

Në shkollat tjera në shtatë (7) komuna në: Deçan, Istog, Junik, Kaçanik, Rahovec, Suharekë dhe Vushtrri është bërë monitorimi dhe vlerësimi inicial- diagnostifikues.

Gjithashtu, gjatë kësaj kohe do të zhvillohet një Hulumtim i shpejtë, me qëllim që të konstatohet pranueshmëria e projektit nga institucionet arsimore, të konstatohet dhe të vlerësohet shkalla e angazhimit të subjekteve në zbatimin e projektit, ndryshimet pozitive që kanë ndodhur deri më tani në zbatim, si dhe ndryshimet që duhet bërë me qëllim që të realizohen objektivat, qëllimet dhe synimet e projektit.

## Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

### Programi i granteve për zhvillimin e shkollave

■ Gjatë muajit tetor janë zhvilluar shumë aktivitete në kuadër të projektit të granteve shkollore. Fokusi kryesor gjatë kësaj kohe ka qenë ndihma shkollave përfituese të rëndësishme të parë për të përfunduar realizimin e projekteve si dhe procedimin e mbetjeve nga realizimi i tyre.

■ Përveç ndihmës që u kanë dhënë shkollave të rëndësishme të parë, BPT kanë qenë të angazhuar të punojnë edhe me shkollat e rëndësishme të dytë, të cilat i kanë përfunduar të dorëzuar propozimet e tyre për miratim.

### KOSOVISION Contest

■ Të gjitha aktivitetet e parapara sipas projektit janë zhvilluar gjatë gjithë muajit tetor. Informimi i gjithë drejtorëve të shkollave me projektin ka përfunduar e po ashtu janë mbajtur edhe trajnimet me mësuesit e klasave të pesta.

Na mesi i muajit tetor, klasat e pesta i kanë zhvilluar punëtoritë e tyre nëpër klasa sipas udhëzimeve të dhëna nga doracakut e mësuesit. Këto punëtori do të vazhdojnë edhe në muajin tjetër.



■ Radio Televizioni i Kosovës është duke përcjell punën e fëmijëve në klasa. Sipas marrëveshjes së bërë me RTK, ata do të përcjellin punën e fëmijëve në të gjitha fazat e realizimit të projektit.



■ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka angazhuar shtatë Inspektorë Rajonal për të përcjellë dhe ndihmuar punën rreth projektit KOSOVISION CONTEST. Inspektorët janë njoftuar me detyrat dhe obligimet e tyre dhe bashkëpunimi i tyre me bashkëpunëtorët e terrenit është në nivel të duhur.

### Parandalimi i dhunës në shkolla

■ Gjatë muajit tetor ekipi i projektit ka zhvilluar disa vizita monitorues në shkollat e Podujevës dhe Gjakovës. Përderisa në Podujevë është zhvilluar monitorimi inicial ose ai i pasqyrimin të gjendjes. Në Gjakovë është zhvilluar monitorimi i ndërmjet që kishte për qëllim të shohë impaktin e implementimit të këtij projekti. Pas përfundimit të vizitave janë duke u hartuar raportet individuale për secilën shkollë të vizituar.

■ Me datën 19 nëntor do të zhvillohet Panairi për të Drejtat e Fëmijës. Gjatë këtij muaji kanë filluar përgatitjen për organizimin e kësaj ngjarje.

## Qasja Tërësektorale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

■ Projekti Qasja Tërësektorale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit 2009. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.

Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

■ Gjatë muajit tetor janë finalizuar dhe shtypur udhëzuesit “MJETET PËR PLANIFIKIM NË ARSIM”. Udhëzuesit janë përgatitur dhe shtypur në tri gjuhë dhe do të shfrytëzohen për punëtoritë që do të mbahen me përfaqësuesit e DKA-ve, në kuadër të aktiviteteve që zhvillon projekti për ngritjen e kapaciteteve të DKA-ve.



■ Gjithashtu, gjatë këtij muaji stafi i projektit bashkë me konsulentë kanë punuar në finalizimin e Katalogut të programeve të trajnimit. Kjo bëhet në kuadër të aktiviteteve që zhvillon projekti për ta përkrahur MASHT, respektivisht Sektorin e Trajnimeve. Pas finalizimit të Katalogut, ai do të shtypet dhe do të shpërndahet tek DKA-të dhe drejtorët e shkollave.

## Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas (EU-SIMRAES)

■ Në kuadër të projektit “Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas”, financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë muajit tetor janë zhvilluar këto aktivitete:

■ Është zhvilluar trajnimi 5 ditor për grupet e Tutorëve. Çdo gjë shkoi në rregull, dhe njëkohësisht menaxhoheshin 2 trajnime: ai i Programit parashkollor dhe Programi i detyrave të shtëpisë.

Trajnerët raportuan të arritura shumë të mira të tutorëve. Ata ishin aktivë dhe kishin ide të reja për t'i implementuar në klasë.



■ Janë zhvilluar disa vizita monitoruese. Nga raportet kuptohet se

---

zbatimi i standardeve nga qasja Hap pas Hapi është duke shkuar mirë. Këto vizita kanë karakter të dyfishtë, ngase përveç monitorimit të gjendjes, nga monitoruesit ndihmojnë qendrat me këshilla specifike. Duhet përmendur se koordinatoret e secilës Qendër Mësimore ishin bashkëpunues duke komunikuar çdo sfidë, të cilat kemi mundur t'i adresojmë dhe zgjidhim së bashku.

■ Implementimi i Programeve shkollore gjatë muajit Tetor ishte korrekt. Secila Qendër u observua për së afërmi nga Koordinatori respektiv, dhe pastaj në baza ditore mund t'i shihnim raportet e rrjedhës së punës si dhe vështirësitë eventuale gjatë implementimit të Programeve.

■ Problemi i përbashkët i të gjitha Qendrave në fillim të Tetorit ishte – ngrohja dhe gjetja e mënyrave për të krijuar një ambient të këndshëm e të përshtatshëm për fëmijët që i frekuentojnë ato.

Të gjitha këto u zgjidhen dhe tani Programet vazhdojnë me ritmin ditor.

*Përgatiti: Petrit Tahiri*